



NH. 5 prot
Dt. 13/02/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 4, datë 10.02.2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR, TË SUBJEKTIT
“KOLA” SH.P.K, ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE
QELËZ, BASHKIA PUKË, QARKU SHKODËR.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës “Për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për ujë të ambalazhuar, në rastin kur përdorimi është për ≤ 150 shishe/orë, ≤ 1 l/s”, të subjektit “Kola” sh.p.k, me vendndodhje: Njësia Administrative Qelëz, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi: Akuiferët me porozitet carje/karst me përhapje të gjërë dhe ujëmbajtje tepër të ndryshueshme, vende – vende mesatarisht të lartë.

Emërtimi i burimit ujqor: Burimi “Puset e Zeza”

Vendndodhja e burimit ujqor (KRGJSH):

X=498565; Y=4665316; Z=1200 m.m.n.d

Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH):

X=492611; Y=4662655; Z=538 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: 0.7 l/s

Prurja mesatare vjetore: 1 l/s

Qëllimi i përdorimit të burimit ujqor: Për ujë të ambalazhuar

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X=492516; Y=4662703; Z=470 m.m.n.d

Sasia e ujit të shkarkuar: 0.1 l/s

Trupi ujqor pritës: Përroi i Gominës

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË



HOLTA DUDA